



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE DURRËS  
ZYRA NOTERIALE ELBASAN

Studio: "Lagjia" "Aqif Pashe Elbasani", Rr" 28 Nentori", Pall. 31/1, Kati 1,  
Elbasan



QKB

Nr. 272 Rep.  
Nr. 1150 Kol.

## KONTRATË SHIT-BLERJE AKSIONESH / KUOTASH

Sot, më datë 06/12 /2019 (dy mijë e nentëmbëdhjetë), ditën Enjte, ne oren: 17:00 para meje Notere: ILA A. PISTOLJA notere pranë Dhomës së Noterëve Durrës, me seli: "Lagjia" "Aqif pashe Elbasani", Elbasan u paraqitën personalisht palët e mëposhtme të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate shitje kuotash si më poshtë:

**FRENK HODAJ** me gjeneralitet: atesia: Ilir, i datelindjes 23.08.1995 lindur ne Vlore dhe banues ne Rr. Ibrahim Rugova, Tirane, identifikuar me pasaporten me nr.J50823107I, leshuar me date 26.12.2017, zoterues i 1 (nje) aksioni qe perbejne 51 % ( pesedhjetë e njeperqind) te kapitalit te shoqerise ( këtu e më poshtë referuar si Shitës)

dhe

**ANILA ÇELA** me gjeneralitetet: atesia: Shefqet, e datelindjes 22.09.1974 lindur ne Polican, Skrapar dhe banues ne lagja Aqif Pasha, Elbasan, identifikuar me leternjoftimin me nr. Personal: H45922002N, leshuar me date 05.04.2011 zoterues i 1 (nje) aksioni qe perbejne 49 % ( dyzet e nentepërqind) te te kapitalit te shoqerise, ( këtu e më poshtë referuar si Blerësit)

Këtej e tutje "Shitësi" dhe "Blerësi", bashkërisht do te quhen "Palët" dhe individualisht secili prej tyre mund të quhet edhe "Pala".

### MEQENËSE

- Shitësi si me siper bashkeaksioner dhe bashkeortak i shoqërisë "IMA PLANET 2018" sh.p.k e themeluar dhe që operon sipas legjislacionit në Republikën e Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Bizneseve sipas numrit unik të identifikimit të biznesit L836072020 me zyrë të regjistruar në adresën: me seli ne : Elbasan, Lagjia 28 Nentori, Bulevardi Qemal Stafa, pall.10/4, ZK8523, Kati Pare, nr.2, pallati tek ish-kinemaja, Elbasan, leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kapital të shoqërisë në shumën 100.000.00 i ndarë në 2 kuota/aksione, me vlerë totale kapitali: 100.000.00 nga ku shitesi disponon pjesen: 1 pra 1 pjese dhe pjesemarrja ne perqindje : 51,00 ( më poshtë referuar si "Shoqëria")
- Shitësi eshte bashke-aksioner me bleresen që ka nënshkruar dhe zotëron 51% të kapitalit të Shoqërisë.

*Frenk Hodaj*  
*[Signature]*

*Anila Çela*  
*[Signature]*



C. Shitësi **FRENK HODAJ** ka ofruar për shitje kundrejt vlerës nominale 51 % të pjesëmarrjes përkatëse në kapitalin e Shoqërisë,

D. Blerësja **ANILA ÇELA** ka shprehur interesin e saj për blerjen e kuotave/pjeseve të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë nga Shitësi të ofruar për shitje ( *bazuar edhe në dispozitat e Statutit të Shoqërisë në të drejten e parablerjes*).

DUKE KONSIDERUAR SA MË SIPËR, Shitësi dhe Blerësi bien dakord që të lidhin këtë kontratë (më poshtë referuar si "Kontrata") si vijon:

#### Neni 1

##### Qëllimi i Kontratës

1.1 Shitësi **FRENK HODAJ** transferon dhe i shtet Blerëses sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë si vijon:

- 51 % të kapitalit të Shoqërisë që përfaqësojnë 1 pjese blereses: **ANILA ÇELA**, kundrejt vlerës së tyre nominale prej 100 lekë secili ("Aksion") e cila pranon dhe disponon Aksionet nga Shitësi sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë në përgjithësi dhe dispozitave të parashikuara në nenin 2 më poshtë, në veçanti.

#### Neni 2

##### Çmimi i Kontratës

2.1 Çmimi i Shitjes sipas kësaj Kontrate për të cilën palet kanë rene dakort është si vijon:

Blerësja ANILA ÇELA blen 51 aksione (pesedhjetee nje), që përfaqësojnë 51 % të kapitalit të Shoqërisë për vlerën 51,000.00 (pesedhjetee e njemijeleke) ("Çmimi i Shitjes"), e cila perben cmimin e shitjes.

2.2 Çmimi i Shitjes është paguar në menyre të plote nga blerësja ANILA ÇELA, për llogari të shoqërisë "IMA PLANET 2018" sh.p.k në formë cash në dorë jashtë kesaj zyre noteriale (si deklaruar dhe pranuar nga palet. )

#### Neni 3

##### Kalimi i pronësisë dhe mbyllja e transaksionit

3.1 Kalimi i titullit të pronësisë mbi Aksionet objekt i kësaj Kontrate, do të kalojë nga Shitësi tek Blerësit, dhe ky i fundit do të bëhet zotëruar me të drejta të plota i pjeseve/aksioneve, që përfaqësojnë 100% të kapitalit të Shoqërisë në datën e depozitimit të kësaj Kontrate dhe regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Bizneseve.

**Administrator i vetem i shoqërisë "IMA PLANET 2018" sh.p.k mbetet DIONIS ÇELA për një periudhë 5 vjetecare, në përputhje me parashikimet e statutit aktual të shoqërisë "IMA PLANET 2018" sh.p.k duke filluar ky afat nga data 13.12.2018 - 02.12.2023.**

#### Neni 4

##### Deklarime dhe Garanci

4.1 Shitësi nëpërmjet kësaj Kontrate deklaron dhe garanton Blerësve se:

- a) Shoqëria është person juridik i regjistruar rregullisht në Regjistrin Tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe ushtron aktivitet tregtar sipas parashikimeve të ligjit në fuqi dhe sipas dispozitave të statutit;
- b) Shitësi i zotëron Aksionet të lira nga çdo peng, barrë siguroese, hipotekë, pengesë, pretendime të tretëve, kufizime, të drejtë parablerje si dhe çdo masë tjetër sigurie apo ligjore;
- c) Shitësi zotëron Aksionet e tij për llogari dhe në emrin e vet, dhe nuk ekziston asnjë "ortak i fshehtë" ose detyrim përta i përket ndarjes së fitimit;
- d) Shoqëria nuk është në proces falimentimi ose likuidimi;
- e) Shoqëria ka paguar të gjitha detyrimet fiskale në përputhje me ligjin në fuqi dhe parimeve të kontabilitetit.

Frenk Hodaj

Anila Çela



4.2 Blerësit me anë të kësaj Kontrate deklarohet dhe garanton Shitësin se:

- a) Blerësit zotëron të gjithë të drejtat ligjore për nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe se këto të drejta nuk janë objekt, apo në kundërshtim, apo nuk përbëjnë shkelje të ndonjë gjykimi, urdhri, vendimi gjyqësor, dekreti ose vendimi të çdo gjykate apo autoriteti shtetëror, subjekt i të cilit është Blerësi, si dhe ndonjë marrëveshje, licence ose angazhimi në të cilin Blerësi është palë që do të cënonte aftësinë e tij për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë.

**Neni 5**

**Tërësia e kontratës dhe ndryshimi i kushteve**

5.1 Nëse, në çdo kohë, ndonjë prej dispozitave të kësaj marrëveshje është ose bëhet e pavlefshme, e pasaktë apo e pazbatueshme në bazë të ligjit të aplikueshëm, pavlefshmëria, pasaktësia apo pazbatueshmëria e kësaj dispozite nuk do të çënojë apo shfuqizojë dispozitat e tjera të kësaj Kontrate. Çdo dispozitë e pavlefshme, e pasaktë apo e pazbatueshme do të zëvendësohet me një dispozitë tjetër të vlefshme, efektive dhe të zbatueshme që pasqyron efektet ligjore të së parës.

5.2 Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve lidhur me parashikimet në të. Titujt apo emërtimet e shprehura në këtë Kontratë janë përfshirë vetëm për lehtësi referimi në tekst dhe në këtë kontratë në tërësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kushteve dhe dispozitave të kësaj Kontrate.

5.3 Çdo parashikim i kësaj Kontrate mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga Palët e kësaj Kontrate, ndryshimet e kryera verbalisht nuk janë të vlefshme.

**Neni 6**

**Juridiksioni dhe mosmarrëveshjet**

6.1 Kjo Kontratë bazohet në, dhe zbatohet sipas ligjit shqiptar, dhe interpretimi, vlefshmëria dhe përmbushja e saj realizohet dhe zbatohet në përputhje me ligjin shqiptar në fuqi. Çdo çështje, detyrim apo kusht që nuk parashi

kohet në këtë Kontrate rregullohet nga ligji shqiptar dhe dispozita të tjera ligjore të aplikueshme.

6.2 Çdo mosmarrëveshje apo kundërshtim si rrjedhojë apo lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj kontrate që nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore ndërmjet Palëve, do të parashtrahet për zgjidhje gjykatës kompetente në Shqipëri nëse palët nuk bien dakord me shkrim.

Ky akt hartohet në 4 (katër) fletë dhe printohet në 4 (kopje) kopje me të njëjtën vlerë ligjore, nga të cilat 3 kopje i jepen Palëve dhe një kopje për arkivën e zyrës sime noteriale. Unë, Noterja pasi ia lexova tekstin e kësaj kontrate me zë të qartë dhe të kuptueshëm palëve dhe pasi ata deklaruan me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, se e kuptuan dhe e gjejnë përmbajtjen e kontratës në përputhje të plotë me thëniet e tyre, e nënshkruan rregullisht në praninë time, dhe unë Noterja vërtetoj këtë kontratë sipas ligjit.

**SHITËS**

FRENK HODAJ

**BLERËSE**

ANILA ÇELA

**NOTERE**

ILA A.PISTOLJA